

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Politika për pjesëmarrjen dhe organizimin e trajnimeve të DPA	Kodi DA-PO-010
		Rishikim nr 3 Dt: 31.03.2021
		Faqe 1 nga 2

Politika për pjesëmarrjen në trajnimet e DPA

1. Qëllimi

Ky dokument përshkruan politikën e Drejtorisë së Përgjithshme e Akreditimit (DPA) në lidhje me trajnimet që organizohen nga Qendra e Trajnimeve të DPA-së.

2. Referenca

Ligji Nr.116/2014 “Për akreditimin, organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 “ Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit kryen trajnime për fushën e akreditimit”

3. Politika

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ka ngritur për këtë qëllim Qendrën e Trajnimit e cila ka për detyrë të hartojë kalendarin e trajnimeve.

Në përputhje me standardin S SH ISO/IEC 17011:2017, paragrafi 4.4.11(b), Qendra e trajnimit pranë DPA kryen trajnime por nuk jep konsulencë, këshilla apo zgjidhje specifike tek organet e vlerësimit të konformitetit në lidhje me aktivitetet e tyre. Trajnimi zhvillohet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga të paktën tre institucione/OVK të ndryshme.

Për çdo trajnim organet e vlerësimit të konformitetit apo institucionet e tjera do të informohen në mënyrë zyrtare në lidhje me datën e organizimit të trajnimit përkatës. Gjithashtu ky informacion do të publikohet në websiten e DPA.

Trajnimet do të kryhen në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit. Lektorë do të jenë punonjës, ose vlerësues teknik të Drejtorisë apo përfaqësues të institucioneve shkencore dhe arsimore të certifikuar nga organizma certifikues personi për trajnime në fushën e menaxhimit.

Numri maksimal i pjesëmarrësve për çdo kurs është 25. Për pjesëmarrjen në këto trajnime aplikohen tarifa të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, të cilat do të përballohen nga ana e pjesëmarrësve (personalisht apo institucioni).

Trajnimet ofrohen pa pagesë për stafin e DPA dhe për vlerësuesit/ekspertët e saj të miratuar. Trajnimet kryhen në gjuhën shqipe me përjashtim kur ato zhvillohen në kuadër të projekteve të ndryshme.

Pjesëmarrja në trajnimet e zhvilluara nga DPA nga ana e organeve të vlerësimit të konformitetit, nuk është kusht për qënien e akredituar. Nga ana tjetër, pjesëmarrja në



Tel: **+355 4 22 69097**
+355 4 22 69325

Fax:

E-Mail: **info@dpa.gov.al**

Politika për pjesëmarrjen dhe organizimin e trajnimeve te DPA

Kodi DA-PO-010

Rishikim nr 3
Dt: 31.03.2021

Faqe 2 nga 2

trajnimet e DPA, nuk thjeshtëzon, lehtëson, përshejton procedurat e akreditimit apo nuk redukton shpenzimet për akreditim.

Edhe në rastet e trajnimeve që zhvillohen me mbështetjen e projekteve, parimi i mosdhënies së konsulencës do të zbatohet.

Data: 31.03.2021

Drejtori i Përgjithshëm
Armond HALEBI